

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Nga plagosja tek atentati në Sarandë/ Si nisi saga e hakmarrjeve dhe si u vr*a “Tani Ruzhdiut” - Informo hu siç duhet
ADRESA	https://radar.al/nga-plagosja-tek-atentati-ne-sarande-si-nisi-saga-e-hakmarrjeve-dhe-si-u-vra-tani-ruzhdiut/
BURIMI	radar.al
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	20 shtator 2026, 11:50:55 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	20 shtator 2026, 11:22:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	5de1095791b234d12f85d8e4391fe5941bdcc143c0aeec7defbb637e1cdaab24
TEKSTI	d5ed506898e5e0926e72d3c9ddac3f3ae10997b06037aa385b7b75d0d2b4c18d
PAMJA	e7eefc4b439609eddc6e4d53269acba7f93458ba24dac39062d3d078e9438f0f

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	49318f4ab812b063af34ed766caa70a925093afc6cf8de6d17bea406d81c7865
E MËPARSHMJA	1bdd76e5bde670b42de240a0051ca458d1fb3f9845c741fb40dad086a7d978d1
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahajo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/49318f4ab812b063af34ed766caa70a925093afc6cf8de6d17bea406d81c7865>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

YOU ARE AT: Home » Nga plagosja tek atentati në Sarandë/ Si nisi saga e hakmarrjeve dhe si u vr*a "Tani Ruzhdiut"

AKTUALITET

Demo

Nga plagosja tek atentati në Sarandë/ Si nisi saga e hakmarrjeve dhe si u vr*a "Tani Ruzhdiut"

SEPTEMBER 20, 2026



Vrasja e 44-vjeçarit Artan Myrtaj në Sarandë rikthen në vëmendje një zinxhir ngjarjesh kriminale që nisi pas një plagosjeje të dyfishtë në korrik të vitit 2025 dhe që më pas u shoqërua me episode të tjera të rënda, përfshirë një vrasje me tritol.

Myrtaj, i njohur edhe me nofkën "Tani Ruzhdiut", u qëllua për vdekje me armë zjarri paraditen e së dielës, pranë zonës së ish-agjencisë në Sarandë. Sipas të dhënave paraprake, dy persona të maskuar, që lëviznin me motor dhe mbanin skafandra, iu afruan dhe hapën zjarr ndaj 44-vjeçarit. Ai mbeti i vrarë në vend, ndërsa nga të shtënat u plagos edhe një kalimtar i rastit.

Hetuesit po punojnë për identifikimin dhe kapjen e autorëve, ndërsa ende nuk është konfirmuar zyrtarisht nëse atentati i sotëm lidhet drejtpërdrejt me konfliktet e mëparshme në Sarandë.

Plagosja e dyfishtë e korrikut 2025

Pikënisja e kësaj historie kriminale daton më 17 korrik 2025, kur në Sarandë u plagosën me armë zjarri Gëzim Hajdaraj dhe Ernest Lama, të dy banues në Kamëz.

Sipas hetimeve të asaj kohe, ngjarja kishte ardhur pas një konflikti të lidhur me një pronë. Policia identifikoi Ramadan Zoton si personin e dyshuar për të shtënat, ndërsa Artan Myrtaj, Klaus Jaçaj dhe Erjon Canaj u shpallën në kërkim për "përkrahje të autorit të krimit".

Artan Myrtaj u arrestua më 20 korrik 2025, pas ekzekutimit të urdhrit të ndalimit të lëshuar nga Prokuroria. Në atë kohë, policia deklaroi se ai dyshohej për veprën penale "Përkrahja e autorit të krimit".

Sipas të dhënave të raportuara për dosjen, Myrtaj, Jaçaj dhe Canaj dyshohej se kishin ndihmuar Zoton gjatë dhe pas ngjarjes, përfshirë largimin e tij nga vendi i plagosjes.

Nga plagosja te hakmarrjet

Pas plagosjes së dyfishtë, në Sarandë u regjistruan edhe episode të tjera kriminale që u lidhën në raportimet mediatike me këtë konflikt.

Një prej tyre ishte vrasja me tritol e Isuf Jaçajt, babait të Klaus Jaçajt. Po ashtu, u raportua edhe për një rast të shkatërrimit të pronës së Ramadan Zotos.

Postimet e reja

Kurti viziton shkollën në Bronx të SHBA-ve ku...

SEPTEMBER 20, 2026

Gjirokastër/ Zjarr pranë fshatit 'Arshi Lengo',...

SEPTEMBER 20, 2026

Bizneset e merrnin në punë, ajo vidhte xhiron ...

SEPTEMBER 20, 2026

Tensionet/ Pheniani lëshon dy raketa balistik...

SEPTEMBER 20, 2026

Mos e humb

FOKUS | SEPTEMBER 15, 2026

Kompania e krijuar tri ditë pas hapjes së thirrjes për grantet e startupeve fitoi 6.1 milionë lekë në fazën e rezervuar për biznese të paktën 1-vjeçare

Pas shpalljes së listës së fituesve të "Grant 2026" kanë nisur të dalin rastet ku...

Skema sesi IUTE zbras fitimin nga Shqipëria, që ju merr konsumatorëve me interesa mbi 30%!

Skandal me sallamin në dyqanet Conad, thirrje konsumatorëve ta kthejnë mbrapsht

6 milionë euro të Startup Albania: Përfituesit, qokat dhe "problematikët"

Na ndiq

Facebook

Instagram

Këto episode kanë krijuar një kronologji të përplasjesh dhe hakmarrjesh mes personave të lidhur me ngjarjen e korrikut 2025. Megjithatë, lidhja konkrete mes tyre dhe atentatit të sotëm mbetet për t'u provuar nga hetimi.

Kush është Artan Myrtaj?

Artan Myrtaj ishte arrestuar në vitin 2025 për akuzën e "Përkrahjes së autorit të krimit", në lidhje me plagosjen e dyfishtë në Sarandë. Ai dhe Klaus Jaçaj, të proceduar për të njëjtën vepër penale, ishin liruar para pak kohësh, ndërsa Erjon Canaj vijon të jetë në kërkim, sipas raportimeve të publikuara sot. Ramadan Zoto ndodhet në burg për çështjen e plagosjes së Gëzim Hajdarajt dhe Ernest Lamajt.

Tashmë hetuesit po përpiqen të zbardhin autorësinë dhe motivin e vrasjes së Artan Myrtajt, ndërsa një nga pistat që po shqyrtohet është edhe historia e konflikteve të mëparshme. Për momentin, kjo mbetet pjesë e hetimit dhe nuk ka një konfirmim zyrtar për motivin e atentatit.

sarande Tani Ruzhdiut

SHARE.



RRETH NESH



Një shikim i thellë në botën e lajmeve, ku teknologjia dhe profesionalizmi takohen për të sjellë lajmet më të fundit dhe të rëndësishme brenda dhe jashtë Shqipërisë. Një burim i besueshëm për informacionin e saktë dhe analizat gjithëpërfshirëse.

NIPT: M47705501A
Email: radarlajme@gmail.com
Kontakt: +355689008000

HOROSKOPI

Njohje të reja për beqarët, mundësi fitimi dhe sfida në punë, çfarë thonë yjet për ju sot

Universi ka një surprizë për këto 3 shenja më 14 shtator

Një ditë me surpriza në dashuri: Horoskopi për të gjitha shenjat

YouTube

TikTok



Aleanca për Media Etike

Artikull joetik?

raporto këtu